


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6731
E premte, 14 tetor 2022
çmimi 0.40 €

Raporti i BE-së për Kosovën vlerëson qëndrueshmërinë e sistemit financiar



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I BASHKIMIT EVROPIAN PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI, MIROSLAV LAJÇAK, KA ARDHUR NË PRISHTINË

LAJÇAK: TË MOS SHPËRDORËT MUNDËSIA PËR ARRITJEN E NORMALIZIMIT KOSOVË - SERBI

OPINION

MODELI I DY GJERMANIVE APO MODELI I BANGLADESHIT PËR KOSOVËN!

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



SA KANË SHPENZUAR QYTETARËT E KOSOVËS PËR VIZA DREJT BE-së?

SFIDAT E KLINIKËS SË ONKOLOGJISË, FURNIZIMI ME BARNË DHE BLERJA E PAJISJEVE TË REJA

EKONOMI



BKS-ja KËRKON NGA AVOKATËT TË BËJNË MARRËVESHJE PËR MBYLLJE TË LËNDËVE 2002-2020

SPORT




LEGJENDA E FUTBOLLIT RUMUN E VLERËSON LART KOSOVËN



Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, është takuar të enjten në Prishtinë me kryeministrin Albin Kurti. Pas takimit me të, Lajçaku ka thënë për mediet se të dyja shtetet nuk duhet ta shpërdorin mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje për

normalizimin e raporteve. Ndërkaq kryeministri Kurti ka ritheksuar se mbetet i përkushtuar për kornizën e përgjithshme të marrëveshjes ligjërish të obligueshme, marrëveshje kjo e cila sjell normalizim të plotë dhe që ka në qendër njohjen reciproke



SBASHK-u DHE KËSHILLI I PRINDËRVE KUNDËR MBAJTJES SË MËSIMIT TË SHTUNËN

IFAQE 3



SHBA-ja PREMTON VAZHDIM TË MBËSHTETJES PËR FSK-në

IFAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Rusia kryen sulme të reja në rajonet ukrainase

KIEV, 13 TETOR - Raketat ruse kanë goditur mbi 40 qytete ukrainase më 13 tetor, thanë zyrtarët. Sulmet ruse kanë pasur për cak infrastrukturën kritike të rajonit të Kievit. Sulmet e reja vijnë një ditë pasi Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë që e quan "ilegal" aneksimin e territoreve ukrainase nga Rusia.


Guvernatori rajonal i Kievit, Oleksiy Kuleba, tha se sulmet janë kryer me dronë të prodhuar nga Irani, që njihen si dronë kamikazë. Sipas tij, ekipet e shpëtimit kanë dalë në vendin e ngjarjes, por ende është e paqartë nëse ka viktima nga këto sulme.

Kyrylo Tymoshenko, nënkryetari i Zyrës Presidenciale të Ukrainës, tha se dronët kanë goditur ndërtesa të infrastrukturës kritike.

Në Mikolajiv gjatë natës është bombarduar një ndërtesë banimi, teksa luftimet po vazhdojnë në mbarë frontin jugor të Ukrainës. "Një ndërtesë pesëkatëshe e banimit është goditur, dy katet e sipërm janë shkatërruar plotësisht, ndërkaq pjesa tjetër e ndërtesës është nën rreñoja. Ekipet e shpëtimit janë duke punuar në vendngjarje", tha kryetari i Mikolajivit, Oleksandr Sienkovych, duke shtuar se ky qytet jugor ukrainas është "bombarduar në mënyrë masive".

Ende është e paqartë nëse ka viktima nga bombardimet në këtë qytet.

Mikolajivi, një qytet-port buzë



lumit Bug, afër Detit të Zi, ka qenë cak i bombardimeve të ashpra qëkur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

Rusia ka sulmuar edhe qytetin jugor të Nikopolit, në rajonin e Dnipropetrovskit, sipas kreut të administratës rajonale, Valentyn Reznichenko. Ai tha se një person është plagosur rëndë, ndërkaq mbi 30 ndërtesa, tubacione gazi dhe linja elektrike janë dëmtuar. "Mbi 2 000 familje kanë mbetur pa energji elektrike. Punëtorët e

energjisë veçse kanë nisur punën për t'i rregulluar dëmet", tha Reznichenko.

Serbia mbështet rezolutën e OKB-së

Më 12 tetor më shumë se tri të katërtat e 193 anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së votuan në favor të rezolutës që e quan ilegale aneksimin e katër rajoneve ukrainase nga Rusia. Një prej shteteve që mbështeti

rezolutën ishte edhe Serbia, e cila, së bashku me Turqinë, të dyja kandidatet për anëtarësim në Bashkimin Evropian, refuzojnë të vendosin sanksione ndaj Ruisisë.

Beogradi edhe në të kaluarën kishte votuar për rezoluta të ngjashme që dënonin pushtimin rus të Ukrainës, por ende vazhdon t'u rezistojë thirrjeve të komunitetit ndërkombëtar që t'i vendosë sanksione Moskës.

Vetëm Siria, Nikaragua, Koreja e Veriut dhe Bjellorusia iu bashkuan Ruisisë, duke votuar kundër rezolutës. Ndërkaq, 35 shtete abstenuan nga votimi, përfshirë Kinën, Indinë, Afrikën e Jugut dhe Pakistanin.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky shkroi në "Twitter" se ishte "mirënjohës ndaj 143 shteteve që mbështetën rezolutën historike të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Përpjekjet e Ruisisë për aneksim janë të pavlera".

Rezoluta "dënon organizimin e të ashtuquajturave referendume nga Federata Ruse brenda kufijve të Ukrainës të njohur ndërkombëtarisht". Po ashtu, aty dënohen "përpjekjet për aneksim ilegal" të Hersonit, Zaporizhjes, Donjeckut dhe Luhanskut, që presidenti rus, Vladimir Putin, shpalli muajin e kaluar.

Rezoluta, po ashtu, u bën thirrje të gjitha shteteve të OKB-së dhe agjencive ndërkombëtare që të mos njohin ndryshimet e njoftuara të kufijve nga Rusia dhe, po ashtu, i kërkohet Moskës "që menjëherë t'i zhbëjë" këto vendime.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se votimi i kësaj rezolute tregon unitetin ndërkombëtar kundër Ruisisë dhe përsëriti se Uashingtoni kurrë nuk do t'i njohë referendumet e rreme ruse.

Ky votim "është një përkujtesë i fuqishëm se shumica e shteteve qëndrojnë me Ukrainën, në mbrojtje të Kartës së OKB-së dhe të bashkuar kundër luftës së Ruisisë ndaj Ukrainës dhe popullit të saj", tha Blinken. "Me vetëm pak shtete që votuan së bashku me Rusinë sot, është e qartë se uniteti ndërkombëtar është i vendosur dhe mbështetja e Ukrainës në OKB dhe gjetkë është e palëkundur", tha Blinken.

Ambasadori rus në OKB, Vasili Nebenzia, tha para votimit në Asamblesë së Përgjithshme, se rezoluta ishte "e politizuar dhe provokim i hapur". Ai shtoi se kjo rezolutë "mund t'i shkatërrojë të gjitha përpjekjet për një zgjidhje diplomatike të krizës".

Votimi i rezolutës në OKB erdhi pasi muajin e kaluar Rusia vendosi veto ndaj një rezolute të ngjashme të paraqitur në Këshillin e Sigurimit.

Muajin e kaluar Moska proklamoi aneksimin e katër rajoneve pjesërisht të pushtuara ukrainase - Donjeck, Luhansk, Herson dhe Zaporizhja - pasi mbajti referendume të rreme në to. Ukraina dhe aleatët e saj i cilësuan referendumet si ilegale dhe thanë se disa votues u detyruan, nën kërcënimin e armëve, që të merrnin pjesë në votime.

Erdogani bën thirrje për ndaljen e "gjakderdhjes" në Ukrainë

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë të enjten se diplomacia mund të ofrojë mundësi "për një paqe të drejtë" që do ta ndalte gjakderdhjen në luftën në Ukrainë pavarësisht prej shumë pengesave dhe përsëriti ofertën e tij për të ndërmjetësuar në bisedime. "Qëllimi ynë është të ndihmojmë ndaljen e gjakderdhjes sa më shpejt që të jetë e mundur pavarësisht prej pengesave në terren", tha Erdogan gjatë një samiti rajonal në Kazakistan.

Lideri turk i bëri këto komente para takimit me presidentin rus Vladimir Putin. "Një paqe e drejtë mund të arrihet përmes diplomacisë", tha Erdogan para liderëve të mbledhur në Astana në Konferencën për Ndërveprim dhe Masat për Ndërtimin e Besimit në Azi.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Buleshkaj mirëpret rekomandimet e Raportit të KE-së për APK-në


PRISHTINË, 13 TETOR - Pas dorëzimit të raportit të vendit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022, drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), Yll Buleshkaj, ka theksuar se rekomandimet e Raportit të Progresit për Kosovën në lidhje me fushëveprimtarinë e APK-së do të jenë fanar orientimi të punës së këtij institucioni për vitin 2023. Raporti i Progresit për Kosovën njih progresin e arritur me

miratimin e legjislacionit të rëndësishëm kundër korrupsionit duke përfshirë Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligjin e ri për Deklarimin e Pasurisë, por edhe punën e madhe të APK-së nën lidhshimin e ri për t'i trajtuar me shpejtësi lëndët e prapambetura. Ky raport konfirmon edhe vetëvlerësimin e APK-së që Kosova duhet t'i forcojë më tej kapacitetet e Agjencisë, në

aspektin e stafit dhe ekspertizës, duke marrë parasysh kompetencat e reja të Agjencisë dhe për të siguruar zbatim efektiv të legjislacionit në fuqi. "Rekomandimet e Raportit të vendit për Kosovën na inkurajojnë që në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit të punojmë së bashku me institucionet e tjera me seriozitetin dhe përgjegjësinë më të lartë institucionale", ka theksuar drejtori i APK-së, Yll Buleshkaj.



SBASHK-u dhe Këshilli i Prindërve kundër mbajtjes së mësimimit të shtunën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 TETOR - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI) ka njoftuar se më 15 tetor do të ketë mësim. "Bazuar në ndryshimet në kalendarin e rishikuar, ju informojmë se dita e shtunë, datë 15 tetor, do të jetë ditë pune për nxënësit e klasave 1-8, sipas orarit të përcaktuar nga shkollat. Gjatë një muaji të grevës janë humbur gjithsej 22 ditë mësimi apo rreth 12 për qind e ditëve të vitit shkollor të cilat duhet të zëvendësohen. Për shkak të çrregullimeve në pandemi, humbjet në arsimin në

Kosovë janë shumë të mëdha, derisa këto humbje janë shtuar edhe më shumë për shkak të grevave", ka njoftuar MASHTI. Sipas kësaj ministrie, muajt në vazhdim mund të ketë çrregullime potenciale që mund të shkaktohen nga problemet e furnizimit me energji elektrike andaj çdo diskutim për mosmbajtje të mësimimit është jo vetëm i dëmshëm, por edhe qëllimkeq e tendencioz. "MASHTI kërkon që të gjitha shkollat të organizohen sa më mirë për mbajtjen e orëve të humbura për shkak të grevës ashtu siç e parashihet kalendarin e rishikuar", ka njoftuar kjo ministri, duke theksuar se Inspektorati i Arsimit do të jetë në

terren dhe do ta mbikëqyrë zbatimin e kalendarit të vitit shkollor. "Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë për sigurimin e organizimit dhe mbarëvajtjes së mësimimit në arsimin parauniversitar, presim që komunat të sigurohen për realizimin e kalendarit shkollor duke filluar nga kjo e shtunë", ka njoftuar MASHTI. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, në një konferencë për medie mbajtur të enjten ka thënë se të shtunën, më 15 tetor, nuk do të ketë mësim. Kontrata kolektive e nënshkruar në vitin 2021, ka thënë Jasharaj, thotë se "orët mësimore të humbura gjatë grevës nuk zëvendësohen, përveç

nëse palët nënshkruese të kësaj kontrate arrijnë marrëveshje të veçantë". Ai ka theksuar se Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit nuk i ka ftuar për të diskutuar për ndonjë marrëveshje të veçantë dhe se vendimi i ministrisë për kompensimin e orëve të humbura është marrë në mënyrë të njëanshme. "Presim që gjatë javës së ardhshme MASHTI të na ftojë në takim dhe të debatojmë për këtë çështje", ka thënë Jasharaj. Edhe Këshilli i Prindërve i Kosovës ka bërë me dije se është kundër mbajtjes të procesit mësimor gjatë të shtunave. Përmes një reagimi, ky këshill ka theksuar se nuk duhet të mbahet mësimi me zor.

Mësimdhënësit ishin futur në grevë me kërkesën për 100 euro shtesë deri në miratimin e Ligjit për Pagave, i cili është ende në konsultime. Qeveria e Kosovës nuk e kishte plotësuar kërkesën e grevistëve, duke thënë se Ligji për Paga, që parashihet rritjen e tyre, do të dalë në miratim së shpejti. Këshilli grevist i SBASHK-ut ka pezulluar grevën deri në janar. Ky pezullim mundësoi kthimin e mbi 300 mijë nxënësve në shkollat publike, i cili rëndom nis më 1 shtator në Kosovë, nisi me një muaj vonë. Po ashtu, me vonë mësimdhënësit i morën edhe pagat për muajin shtator.

Zhvillimet aktuale në vend e rajon, temë diskutimi mes Osmanit dhe Hovenierit

PRISHTINË, 13 TETOR - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të enjten në takim të rregullt ambasadorin e ShBA-së, Jeffrey Hovenier. Osmani dhe Hovenier kanë diskutuar për zhvillimet aktuale në vend dhe rajon.

Presidentja Osmani ka theksuar se Kosova është në koordinim të plotë me ShBA-të në raport me adresimin e çështjeve prioritare. Në takim u diskutua edhe për dialogun me Serbinë dhe përpjekjet e shteteve aleate

për dinamizim të tij. Presidentja Osmani nënvizoi se dialogu duhet të përmbyllet me njohje të ndërsjellë dhe pa prekur rendin kushtetues, integritetin territorial, sovranitetin dhe funksionalitetin e vendit.





PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I BASHKIMIT EVROPIAN PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI,
MIROSLAV LAJÇAK, VJEN NË PRISHTINË

Lajçak: Të mos shpërdoret mundësia për arritjen e normalizimit Kosovë - Serbi

Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, është takuar të enjten në Prishtinë me kryeministrin Albin Kurti. Pas takimit, Lajçaku ka thënë për mediet se të dyja shtetet nuk duhet ta shpërdorin mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje për normalizimin e raporteve. Ndërkaq, kryeministri Kurti ritheksoi se mbetet i përkushtuar për kornizën e përgjithshme të marrëveshjes ligjërish të obligueshme, marrëveshje kjo e cila sjell normalizim të plotë dhe ka në qendër njohjen reciproke

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 TETOR - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, tha se dy shtetet nuk duhet ta shpërdorin mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje për normalizimin e raporteve. Lajçak këtë deklarata e bëri për gazetaret në Prishtinë më 13 tetor, pasi zhvilloi një takim dyorësh me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe zëvendësin e tij, Besnik Bislimi. "Nuk do të thosha që viti tjetër është vendimtar, por e kam thënë më shumë se një herë se e kemi këtë dritare mundësie që do të zgjasë deri në zgjedhjet evropiane dhe amerikane më 2024. Mendoj se është përgjegjësia jonë që të mos e shpërdorojmë këtë mundësi", ka thënë Lajçaku kur u pyet nëse vitin e ardhshëm Kosova dhe Serbia do të mund të arrijnë ndonjë marrëveshje. Ai ka theksuar se në takimin me

Kurtin ka biseduar edhe për "diskutimet që ne kemi nisur së fundmi" që, sipas tij, kanë vazhduar përmes ndërhyrjes së presidentit të Francës, Emmanuel Macron, kancelarit gjerman Olaf Scholz dhe bisedës telefonike që sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka zhvilluar me liderët e Kosovës dhe Serbisë. "Ne kemi diskutuar për hapat e mëtejme dhe pika e dytë në agjendë ishin çështjet aktuale, veçanërisht çështja e energjisë dhe e targave. Sepse, siç e dini, afati i fundit për targat e makinave është më 31 tetor dhe është shumë e rëndësishme për mua dhe për ne si BE dhe komunitet ndërkombëtar të dimë se cilat janë planet dhe të shmangim ndonjë përshkallëzim të situatës. Kjo nuk është në interesin e askujt", ka deklaruar Lajçaku. Lajçaku, po ashtu, tha se e ka informuar Kurtin për përfundimet e një takimi të mbajtur të hënën në Bruksel midis përfaqësuesve të sektorit të

energjisë së Kosovës dhe Serbisë lidhur me marrëveshjen për energjinë, që palët arritën më herët gjatë vitit, duke paralajmëruar se mund të tërhiqet licenca për kompaninë serbe "Elektrosever". Ndërkaq nga Zyra e Kurtit njoftuan se në takim është diskutuar për përgatitjet e takimit të radhës të dialogut në Bruksel. "Në takim u bisedua për ecurinë e mëtejshme të procesit të bisedimeve në Bruksel dhe për përgatitjet për takimet e radhës në kuadër të dialogut për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Kryeministri Kurti ritheksoi se Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për kornizën e përgjithshme të marrëveshjes ligjërish të obligueshme, marrëveshje kjo e cila sjell normalizim të plotë, sepse e ka në qendër njohjen reciproke", bëhet me dije në njoftimin e qeverisë.

Më tutje theksohet se gjatë takimit u potencua Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, i pranuar dje, si dukshëm më i mirë sesa vitin e kaluar dhe si një ndër raportet më të mira në rajon. "U tha se ky raport tregon qartë përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për agjendën e BE-së dhe dëshmon arritjet e shënuara në shumë fusha, që kanë kaluar një hap më lart në shkallët e progresit. U bisedua për çështjet aktuale, si dhe domosdoshmërinë e zbatimit të marrëveshjes për energjinë, që përfundimisht shpie në pagesën e energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës", ka njoftuar Qeveria e Kosovës. I dërguari i bllokut evropian për dialogun tha se do ta vizitojë javën e ardhshme Beogradin, me të njëjtin qëllim dhe agjendë. Vizita e Lajçakut në Kosovë më 13 tetor erdhi në kohën kur mediet kanë raportuar se Franca dhe Gjermania ua kanë paraqitur Kurtit dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, një propozim për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Vuçiqi deklaroi më 8 tetor se Parisi dhe Berlina kanë propozuar që shteti i tij të lejojë që Kosova të anëtarësohet në institucione dhe organizata ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara, në këmbim të anëtarësimit të shpejtë

të Serbisë në BE.

Ndërkaq Kurti tha më 12 tetor se nuk ka propozim për marrëveshje finale. "Ka diskutime, ka opsione, ka teste e prova, por nuk mund të them që ka diçka të ngurtësuar që do ta prezantonim në formë përfundimtare", ka deklaruar Kurti gjatë një konference për medie në Prishtinë.

Ambasada e Francës dhe e Gjermanisë në Prishtinë nuk kanë konfirmuar nëse ekziston një propozim i tillë, por kërret e këtyre dy shteteve, Emmanuel Macron dhe Olaf Scholz, përmes një letre të dërguar në shtator, kërkuar nga Kurti dhe Vuçiqi të jenë të gatshëm për vendime të vështira në dialog. Përveç shteteve evropiane, që po tentojnë t'i shtyjnë përpara palët drejt një marrëveshjeje, Shtetet e Bashkuara, po ashtu, po kërkojnë që takimet të shtohen.

Në këtë kuadër, sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, më 11 tetor tha se ka biseduar me Kurtin dhe Vuçiqin për nevojën e "shtimit të procesit të dialogut drejt një marrëveshjeje ligjërish të obligueshme me njohje reciproke në qendër të saj".

Kosova dhe Serbia që nga viti 2011 zhvillojnë dialog nën ndërmjetësimin e BE-së. Këto dy shtete, megjithatë, kanë qëndrime të kundërta sa i përket përfundimit të dialogut.

Sa kanë shpenzuar qytetarët e Kosovës për viza drejt BE-së?

PRISHTINË, 13 TETOR - Në janar të vitit 2012 Komisioni Evropian i BE-së nisi zyrtarisht dialogun me Kosovën për procesin e liberalizimit të vizave. Që nga nisja e këtij dialogu e deri në fund të vitit 2021 kosovarët kanë parashtruar 659 029 aplikime për vizë Schengen sipas të dhënave të Komisionit Evropian.

Më 13 tetor pritet të nisë procedura që u jep fund këtyre aplikimeve pasi që liberalizimi i vizave për Kosovën është në rend dite të diskutimeve të

grupit punues të Këshillit të Bashkimit Evropian.

Çështja e liberalizimit të vizave u përmend edhe në Raportin e Progresit për Kosovën të Komisionit Evropian të publikuar më 12 tetor. Aty përsëritet se Komisioni Evropian vlerëson se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret. Por, shqetësim mbetet rreziku i keqpërdorimit eventual të lirisë së lëvizjes për të kërkuar azil në vendet e BE-së.

Sipas të dhënave të Grupit për

Ballkanin (BRPG), 60 për qind e qytetarëve të Kosovës kanë kërkuar vizë Schengen, që mundëson lëvizjen e lirshme në vendet e BE-së për vizita turistike. Interesimi i kosovarëve për t'i vizituar vendet e BE-së kishte qenë në rritje deri në vitin 2020, kur trendi ndryshoi shkaku i Covid-19.

Sipas një hulumtimi të bërë nga BRPG-ja, qytetarët e Kosovës kanë paguar mesatarisht 165 euro për aplikimin për vizë Schengen.

Kjo kosto arrin shifra prej dhjetëra miliona eurosh kur merret parasysh numri i aplikimeve në vit.

Po i njëjti hulumtim i BRPG-së thekson se kosovarët kanë pritur mesatarisht nga një deri në gjashtë muaj deri në përfundimin e procedurës për vizë në zonën Schengen. Përveç kësaj priteje, qytetarët e Kosovës janë ankuar edhe për pritje të gjata në rend për dorëzimin e dokumenteve.

Por, me gjithë pritjet e gjata dhe paratë e shpenzuara gjatë

aplikimit, një numër i aplikuesve është përballur me përgjigje negative.

Komisioni Evropian në vitin 2018 kishte propozuar liberalizimin e vizave për Kosovën. Edhe Parlamenti Evropian e kishte mbështetur këtë vendim, mirëpo vendet si Franca dhe Holanda nuk ishin të pajtimit.

Kosova është vendi i vetëm i Ballkanit Perëndimor, qytetarët e të cilit nuk e kanë të drejtën e lëvizjes së lirë në zonën Schengen.



Qeveria formon dy grupe punuese për realizimin e Programit Kompakt me MCC-në

PRISHTINË, 13 TETOR - Në mbledhjen e 100 Qeveria e Kosovës ka votuar formimin e dy grupeve punuese ndërinstucionale për realizimin e Programit Kompakt me MCC-në: Grupin për arritjen e parakushteve dhe grupin punues për themelimin e entitetit për menaxhimin e Aktivitetit Shumëfunksional të Ruajtjes së Energjisë (ShFRE).

Këto dy grupe, me përkrahje të institucioneve tona, do të sigurojnë mekanizëm përkrahës për qytetarët në nevojë për ta zburuar koston e energjisë, përsheptim të lejeve dhe instalimeve për teknologjitë e reja të prodhimit të energjisë, integrim të

rezervave të energjisë, themelim të ndërmarrjes publike për rezerva të energjisë, rritje të pavarësimit të sistemit energjetik, zhvillim e trajnim të fuqisë punëtore në energji, rritje të përfshirjes së grave në sektor të energjisë si dhe krijim të mekanizmave për tranzicion të gjelbër.

Qeveria e Republikës së Kosovës së bashku me ShBA-në janë duke zbatuar me përkushtim projektin më të madh në sektorin e energjisë në vend. Ky projekt do ta përmirësojë mirëqenien e qytetarëve tanë si dhe do t'i ndihmojë vendit të krijojë një të ardhme të qëndrueshme në sektorin e energjisë.



Modeli i dy Gjermanive apo modeli i Bangladeshit për Kosovën



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Duhet t'i kërkohej falje Baton Haxhiut: Kohë më parë portali 'Albanian Post', që drejtohet nga Baton Haxhiu, doli me një informatë, si koncept letër, për një propozim të Francës dhe Gjermanisë për një zgjidhje të përkrahshme në formë të një marrëveshjeje jopërfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë sipas modelit të dy gjermanive. Realisht, ky model përfliet edhe më herët, por se refuzohej thuaja nga të gjithë, sepse as ndërkombëtarët nuk ishin të qartë se cilën rrugë duhej ta ndiqnin. Ndërkombëtarët gjithmonë e propozojnë rrugën më të lehtë me rezultat win-win, fitues janë të gjitha palët, duke e drejtuar presionin kah pala më e dobët, në rastin konkret kah Kosova. Serbia, në saje të pozitës strategjike gjeografike dhe përkrahjes së vazhdueshme nga Rusia, Kina, India, Brazili, shumica e shteteve arabe, pjesërisht Turqia, me përkrahje të heshtur nga Franca dhe qëndrim oportunist të Gjermanisë së kohës së Shrederit dhe Angela Merkelit, kishte përparësi të madhe duke e vënë Kosovën në pozitë mbrojtëse. Pas krimeve makabre që shteti serb i kreu në Kosovë gjatë 100-vjeçarit të fundit, me theks të veçantë në luftën e viteve 1998-1999 u krijua një mundësi që njëherë e mirë të zgjidhet mosmarrëveshja dhe papajtueshmëria historike midis Serbisë dhe Kosovës në kontekstin e Serbisë, si okupatore dhe Kosovës që asnjëherë nuk i ndali përpjekjet për liri dhe çlirim. Faktori përcaktues për këtë ishte bashkësia ndërkombëtare e cila, po të kishte vullnet politik, qysh në qershor të vitit 1999 do ta noterizonte gjendjen faktike në terren duke e njohur pavarësinë e Kosovës për faktin se Serbia ishte nokautuar politikisht dhe ushtarakisht! Në këto rrethana, edhe opinioni në Serbi më lehtë do ta pranonte këtë

zgjidhje sepse nuk kishte fare hapësirë për manovrim politik, kurse ushtarakisht as që kishte mundësi të intervenonte shkaku se ishte një forcë e madhe ushtarake ndërkombëtare e vendosur në Kosovë, përkatësisht ishte KFOR-i, si mekanizëm ekzekutiv i NATO-së. Politika oportuniste dhe dyfytirëse ndërkombëtare bëri që Serbia të konsolidohet politikisht dhe, me heqjen e embargos për armatim, edhe ushtarakisht. Misionet ndërkombëtare më shumë i udhëzonin serbët ta kundërshtonin integrimin e serbëve në institucione sesa që të bëhen pjesë konstruktive e shoqërisë. Në vend të afimit u thelluan përçarja dhe ndarja, thuaja sipas vijave etnike. U krijuan enklavat njëetnike (për ta improvizuar rrezikun që iu kanosej serbëve), u përligj kufiri i ndarjes së pjesës veriore të Kosovës e në lumin Ibër që administrohej nga Beogradi, si pjesë e okupimit administrativ, u krijuan zonat e mbrojtura sipas planit të kriminelit juridik Mati Ahtisari, u dhunua Kushtetuta e Kosovës nga një pako kriminale duke e futur Kosovën në një labirint, thuaja pa dalje apo vetëm me një dalje, kah Beogradi dhe Serbia. Realisht, as politikanët e Kosovës nuk u shquan se ishin të zgjuar duke pranuar thuaja të gjitha kushtet e imponuara dhe duke e shndërruar tërë procesin e bisedimeve në një proces teknik që i përshtatej Serbisë sepse krijonte dhe siguronte jetëgjatësi të krizës e që i përshtatej Serbisë. Në këto rrethana doli në skenë një lëvizje e quajtur KAN që udhëhiqej nga kryeministri aktual, Albin Kurti, për t'u shndërruar pastaj në Lëvizjen Vetëvendosje. Në aspektin e promovimit medial dhe përafimit me popullin, Albin Kurti e kishte përkrahjen 100 për qind të Bacës Adem Demaçi, deri në kohën kur Baca Adem u bind se këto ishin

përralla dhe u largua nga përkrahja e LV-së. Rinia, por edhe qytetarët idealistë, u rreshtuan krahu Vetëvendosjes shkaku se mendonin se do t'i pengojnë proceset e dëmshme për Kosovën që ishin evidente sikur edhe për faktin se thuaja si qëllim, të jesh apo të mos jesh, politikisht dhe kombëtarisht e kishin bashkimin kombëtar që ishte, jo vetëm ideal, por edhe qëllimi kryesor i të gjithë patriotëve shqiptarë, që nga koha e Rilindjes Kombëtare e deri më sot. Në ndërkohë, në rrethana të një presioni dhe shantazhi të pashembullt u formua Gjykata Raciste Speciale dhe LV-së, pasi ishte në opozitë, me mjeshtri përfitoi duke votuar kundër kësaj gjykate. Sot, kur janë në pozitë, me të gjitha mjetet e mundshme i luftojnë ish-themeluesit dhe ish-drejtesit e UÇK-së dhe udhëheqësit më të lartë thuaja të të gjitha institucioneve të Kosovës që mbahen si pengje në Gjykatën Speciale Raciste në Hagë. Nuk ka bashkim kombëtar. Jo që nuk duam ne, por Kushtetuta e Kosovës e pamundëson këtë bashkim. Ky nen i Kushtetutës nuk paska qenë më parë, por se ka hyrë në fuqi vetëm pasi u mor pushteti, me qëllim që ta pamundësojë realizimin e premtimit elektoral. Çfarë mashtrimi dhe manipulimi i ulët!

Pas bërjes publike të propozimit francezo-gjerman kishte filluar një linçim publik i Baton Haxhiut në vend që pikërisht kryeministri Kurti, presidentja e kryeministrit Kurti, Vojsa Osmani dhe Sizifja që ia ka futur vetes në kokë se është ministre për Punë të Jashtme, ta informojnë opinionin dhe qytetarët për këtë propozim, për aq sa kanë pasur mundësi ta bëjnë, sepse asnjë propozim nuk bëhet publik në tërësi deri në kohën kur arrihet një pajtueshmëri për pranim apo refuzim të këtij propozimi. Jo që

nuk e bën këtë, por pabesisht mohuan se ekziston një propozim i tillë. Për të dalë disi nga kjo situatë, kryeministri Kurti shkoi, pa paralajmërim, në një drekë pune me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, të cilin ndryshe e konsideron si armik dhe opinionit i shpërndau shqetësimin për mungesën e energjisë elektrike dhe sulmet kibernetike. Vetëm budallai beson në këtë arsytim! Edi Rama pa asnjë dyshim është kryeministri më i suksesshëm shqiptar dhe më i angazhuari për çështjen e Kosovës gjatë tërë ekzistencës së shtetit shqiptar. Deri në kohën kur ky angazhim po i mohohet nga Albin Kurti dhe mbetjet mortore ideologjike në Tiranë dhe Prishtinë duke e akuzuar për paternalizëm në kohën kur Kosova qenka shtet i pavarur dhe sovran. Dhe Edi Rama angazhimin e tij për Kosovën e ka tkurrur sipas rrethanave të krijuara. Po të mos ishte Shqipëria dhe politikanët shqiptarë, me të gjitha të metat dhe gabimet, shqiptarët e Kosovës do ta kishin fatin e kurdëve dhe të palestinezëve, pa asnjë dyshim. Nejshe, së fundi edhe botërisht u pranua se udhëheqësve të institucioneve të Kosovës, kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, presidentit të Kosovës, Albin Kurti dhe kryetarit të Kuvendit, Albin Kurti i është dorëzuar një propozim i tillë. Ky propozim u noterizua nga sekretari i Shtetit të ShBA-së, Blinken, i cili paska biseduar me kryeministrin Kurti për të arriturat historike të qeverisë Kurti 2 në fushën e zhvillimit ekonomik prej 11 për qindësh, 40 000 vendeve të reja të punës, kontributin për luftën e Ukrainës dhe zgjidhjen e problemeve të tjera globale për të cilat nuk kishin zgjidhje, as ShBA-ja e as aleatët evropianë! Nuk e kam të qartë nëse sekretari Blinken ka qenë i informuar për suksesin e madh të Kosovës në planin diplomatik. Është e papërfillshme nëse llogaritet si sukses liberalizimi i vizave për Kosovën krahasuar me suksesin historik siç është liberalizimi i vizave me Bangladeshin për udhëheqësit politikë të Kosovës dhe zyrtarët e lartë të shtetit. Populli është parashikuesi më i saktë i zhvillimeve politike dhe jo vetëm politike; qe një kohë të gjatë thoshte se u bë Kosova - Bangladesh. Për fillim, janë vizat!

Modeli i dy Gjermanive: Modeli i dy Gjermanive është modeli më i keq për Kosovën dhe, nëse është ashtu siç ka rrjedhur në opinion, zgjidhjen e çështjes vetëm do ta shtyjë për 10 vjet e që as atëherë nuk do të jetë zgjidhje përfundimtare. Ky model, gjithnjë sipas asaj që dukej në medie, 100 për qind është në interes të Serbisë dhe 100 për qind kundër interesave të Kosovës. Mjaftueshëm është humbur kohë deri tani për të lejuar edhe një prolongim 10-vjeçar, Kosova ka

nevojë për një zgjidhje përfundimtare radikale që nuk lë asnjë paqartësi qoftë edhe për 10 minuta pas nënshkrimit të marrëveshjes e lëre më të tërhollohet dhe stërzgjatet për një periudhë 10-vjeçare. Pas 10 vjetësh askush nga ndërkombëtarët, nëse kështu vendoset, nuk do të merret seriozisht me Kosovën, përveç Serbisë.

Për zgjidhjen e çështjes së Kosovës duhet një kirurgji e thellë politike e jo një terapi paliative (për zbutje të dhimbjeve) 10-vjeçare. Modeli i dy Gjermanive si përfundim i vetëm logjik dhe faktik kishte formimin e një shteti të vetëm gjerman, dhunshëm i ndarë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore! A është modeli i dy gjermanive i propozuar për Kosovën një model që garanton një Serbi unitare, me Kosovën brenda kufijve, pas 10 vjetësh, si njësi federative apo konfederative, nuk ka rëndësi?! Ky është një propozim shajzen dhe nuk është kurrfarë zgjidhje. Duhet të refuzohet, pa asnjë dyshim. Nëse është ashtu siç ishte bërë publik më herët! Nëse këmbëngulet në këtë propozim atëherë duhet që pala e Kosovës të këmbëngulë për një referendum për bashkim me Shqipërinë. Nuk ka tjetër zgjidhje afatgjatë dhe të qëndrueshme përveç kësaj. Po e shohim se Republika Serbe po sillet si pjesë e Serbisë në Bosnjë- Hercegovinë, po kështu nesër do të sillet edhe Zajebnica në Kosovë. Zajebnicën ndërkombëtarët do ta formojnë në Kosovë edhe me çmim të mbetet vetëm një serb në Kosovë. Është punë e kryer, me një ambalazhim maskues dhe mashtrues. Sikur që edhe Pop Sava Janjiq do të bëhet pronar i 24 hektarëve të pronës shoqërore, si kryetar dhe kryeparlamentar i Manastirit të Deçanit. Këto janë penalltitë kryesore për Serbinë dhe ndërkombëtarët në portën e pambrojtur mjaftueshëm të Kosovës.

Si ngushëllim për këtë perspektivë të zymtë, Kosova po ecën para; do ta votojmë ligjin për martesë të së njëjtës gjini ku Hasani dhe Hyseni, në një marrëdhënie bashkëshortore të shenjtë dhe të mbrojtur me ligj, do të kenë edhe fëmijë. Ëndërr e kamotshme që tani po bëhet realitet. Pastaj, do ta organizojmë një festë shtetërore kur Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi do të dënohen me burg të përjetshëm, nëse dënohen vetëm me 40 vjet do të ndihemi të pikëlluar dhe do t'i shfrytëzojmë të gjitha të drejtat e kundërshtimit, deri te Gjykata Supreme e Serbisë!

Por, unë e quaj sukses të jashtëzakonshëm heqjen e pakushtëzuar të vizave për politikanët dhe zyrtarët e lartë të Kosovës nga Bangladeshi dhe anasjelltas. E papërsëritshme dhe e paimagjinueshme për të besuar se vjen kjo ditë. Mirëpo, ERDHI DITA!

Lladrovci: Rama demaskoi trillimet ruso-serbe të rezolutës famëkeqe të Dick Martyt



DRENAS, 13 TETOR - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka falënderuar kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, për fjalimin e tij në Këshillin e Evropës. Ai ka thënë se Rama shpërfaqti të vërtetën e fuqishme në Strasburg. "Kryeministri i Shqipërisë dhe i shqiptarëve, z. Rama, shkëlqeu dje në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Z. Rama, siç e ka zakon me fjalorin e tij mbresëlënës, të qartë dhe të argumentuar, mbrojti fuqishëm luftën e drejtë e çlirimtare të ushtrisë së lavdishme, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai demaskoi trillimet ruso-serbe të rezolutës famëkeqe të Dick Martyt. Një prezantim i tillë dinjitoz është një hap shumë i rëndësishëm drejt jetësimit të nismës së Ramës për një rezolutë të re të Këshillit të

Evropës, me të cilën do të zbardhet e vërteta dhe do të hidhen në koshin e plehrave insinuatat të cilat u ngjajnë filmave fantastikë-shkencorë për trafikim të organeve, në kohën kur njerëzve u kanë munguar trajtimet elementare mjekësore. Kryeministri Rama shkëlqeu. Mirënjohje dhe falënderim. Po tanë?", ka shkruar Lladrovci në "Facebook".

ShBA-ja premtion vazhdimin e ofrimit të mbështetjes për FSK-në

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 TETOR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe komandanti i FSK-së, gjeneraljejtënant Bashkim Jashari, u takuan me zëvendëssekretaren e Mbrojtjes për Politika, në kuadër të Departamentit të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Sasha Baker. Në këtë takim u bisedua lidhur me tema të ndryshme e me rëndësi të veçantë si për progresin e FSK-së, rolin e Republikës së Kosovës në ruajtjen e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor dhe qëndrimin e qeverisë në situatën aktuale gjeopolitike, luftën në Ukrainë etj. Me këtë rast, Baker shprehu vlerësim të lartë për qasjen dhe

kontributin e Republikës së Kosovës, sidomos për evakuimin e refugjatëve afganë dhe gatishmërinë për t'i trajnuar dhe pranuar refugjatë ukrainas. Gjithashtu, u bisedua për nevojat e FSK-së sa i përket furnizimit me armatime, si dhe gatishmërinë që si shtet e ushtri kemi për të bashkëpunuar në çdo nivel ngaqë, siç theksoi ministri Mehaj, zhvillimi i brendshëm, por edhe stabiliteti i gjithëmbarshtëm i shteteve varen nga shkalla e bashkëpunimit. "Republika e Kosovës është e lidhur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me çdo shtet anëtar të NATO-s që beson në vlerat demokratike dhe në lirinë e kombeve", ka thënë Mehaj, duke shtuar se qëndrimi i Republikës së Kosovës dhe



përparimi që FSK-ja ka arritur me implementimin e Planit të Përgjithshëm të Tranzicionit, por

edhe qeverisjes qendrore në përgjithësi, bëjnë që shteti i Kosovës të perceptohet si një aleat

i besueshëm i ShBA-së dhe shtet kyç në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajonin e Ballkanit.

ShBA-ja sërish i bën thirrje qeverisë Kurti ta zbatojë vendimin për Manastirin e Deçanit



PRISHTINË, 13 TETOR - Ambasada Amerikane në Prishtinë sërish i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga Albin Kurti, që ta zbatojë vendimin për tokën e Manastirit të Deçanit.

Në një përgjigje dërguar "Radios Evropa e Lirë", Ambasada Amerikane tha se vendimi i vitit 2016 i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ka të bëjë me sundimin e ligjit, "jo me etninë, politikën apo fenë". "Qeveria Kurti u zgjodh mbi një platformë të përqendruar në

forcimin e sundimit të ligjit. Respektimi i vendimeve të gjykatës nuk është çështje e zgjedhjes, dhe sigurisht nuk është çështje negociatash, politikash apo arritjesh të ndonjë marrëveshjeje", thuhet në përgjigjen e Ambasadës Amerikane dërguar REL-it. Në maj të vitit 2016 Gjykata Kushtetuese e Kosovës vendosi që t'i njihet e drejta e pronësisë Manastirit të Deçanit për 24 hektarë tokë.

Pavarësisht se vendimet e Kushtetueses - si instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë - janë të formës së prerë dhe obliguese për të gjitha palët, ligji nuk parasheh "dënim" për mosbindje ndaj vendimeve të kësaj gjykate. Vendimin për kthimin e pronave të Manastirit të Deçanit po refuzojnë ta zbatojnë autoritetet lokale në Deçan pavarësisht prej thirrjeve të shumta të diplomatëve amerikanë dhe evropianë se ky vendim duhet respektuar.

Sfidat e Klinikës së Onkologjisë, furnizimi me barna dhe blerja e pajisjeve të reja

PRISHTINË, 13 TETOR - Ushtruesja e detyrës e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, Pranvera Zejnullahu-Raçi, bashkë me menaxhmentin e Klinikës së Onkologjisë, pritën në takim anëtarët e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi gjersa po shënohet "Tetori rozë", muaji i ndërgjegjësimit për luftën kundër kancerit të gjirit. Zejnullahu-Raçi i falënderoi

deputetët për vizitën, para të cilëve shpalosi punët në muajt e fundit, për ta përmirësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për pacientët e prekur me tumor, përfshirë këtu edhe pacientët e sëmurë me kancer të gjirit. Por, listoi edhe sfidat e Klinikës së Onkologjisë, mes tyre furnizimin me barna, blerjen e pajisjeve të reja dhe përmirësimin e kushteve infrastrukturore që, për t'u

zgjidhur, kërkojnë mbështetje të fortë institucionale. Deputetët e Kuvendit të Kosovës falënderuan stafin e Onkologjisë për punën e jashtëzakonshme, ndërkaq ofruan mbështetje maksimale dhe njëzëri u zotuan se të gjitha çështjet do të trajtohen me prioritet në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, me synim që ato të përfshihen në buxhetin e vitit të ardhshëm.



Raporti i BE-së për Kosovën vlerëson qëndrueshmërinë e sistemit financiar

Raporti i publikuar për Kosovën nga Komisioni Evropian njih masat e ndërmarra nga ana e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për rritjen e vazhdueshme dhe qëndrueshmërinë e sektorit financiar. Sipas këtij raporti, në mënyrë të moderuar është e përgatitur në fushën e shërbimeve financiare



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 TETOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka mirëpritur raportin e publikuar për Kosovën nga Komisioni Evropian, i cili njih masat e ndërmarra nga ana e BQK-së për rritjen e vazhdueshme dhe qëndrueshmërinë e sektorit financiar.

Raporti ka vlerësuar se në gjysmën e parë të këtij viti kreditë shënuan rritje prej 17-përqindësh. Rritja e kredive u lehtësua nga normat e ulëta të interesit, rritja e vazhdueshme e depozitave, përmirësimi i zbatimit të kontratave dhe rritja e garancive të dhëna nga Fondi Kosovar për Garanci të Kredive (FKGK) për kreditimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për ta zbutur ndikimin e krizës. Gjithashtu, norma mesatare e kredive

joperformuese në gjysmën e parë të vitit 2022 ishte 2.1 për qind dhe kjo përqindje u mbajt falë rritjes së lartë të kredive.

Kosova, sipas raportit, në mënyrë të moderuar është e përgatitur në fushën e shërbimeve financiare. Gjithashtu, raporti vlerëson përparimin edhe në adresimin e çështjes së automjeteve të pasiguruara dhe të paregjistruara.

Banka Qendrore e Kosovës ka vazhduar ta harmonizojë kornizën e saj ligjore me kërkesat e Basel III sa i përket kapitalit dhe menaxhimit të rrezikut.

Sektori financiar mbetet i qëndrueshëm pavarësisht prej sfidave ekonomike globale për shkak të niveleve të larta të kapitalizimit të sektorit bankar me pronësi të huaj.

Në përgjithësi, raporti i kapitalizimit të bankave mbeti i qëndrueshëm dhe shumë mbi

nivelin minimal të kërkuar të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 12-përqindësh.

Raporti flet edhe për funksionalizimin e Bordit të BQK-së me emërimin e tre anëtarëve joekzekutivë, duke potencuar domosdoshmërinë e ruajtjes së pavarësisë së BQK-së. Raporti, gjithashtu, ka përmendur edhe moskrijimin e autoritetit të pavarur të rikuperimit dhe përmbylljes, i cili varet nga ndryshimet që duhet t'i bëhen ligjit për bankat, përmes të cilit ky funksion i caktohet Bankës Qendrore dhe duhet të sigurohet që autoriteti të ketë pavarësi funksionale brenda BQK-së.

Gjithashtu, raporti përfshin edhe zhvillimet në sektorin e sigurimeve dhe atë të pensioneve, si dhe zbatimin e vazhdueshëm të masave të Solvencës I dhe fillimin e zbatimit gradual të një

udhërrëfyese pesëvjeçar për zbatimin e masave të Solvencës II.

Sa iu përket sigurimeve dhe pensioneve, Banka Qendrore duhet ta rritë rolin mbikëqyrës në industrinë e sigurimeve. Në lidhje me liberalizimin e çmimeve në tregun e sigurimeve të detyrueshme, komisioni ka kërkuar që çfarëdo proces i liberalizimit të çmimeve duhet të fillojë në mënyrë graduale me qëllim të shmangies së çrregullimeve në treg.

Komisioni Evropian ka sugjeruar që vitin e ardhshëm të harmonizohet më tej korniza ligjore e Kosovës me Direktivën e BE-së për Shërbimet e Pagesave 2, rritjen e përpjekjeve për ta luftuar krimin ekonomik dhe financiar, si dhe përafrimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit me

aktet (aquis) të BE-së, pastaj forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar.

Në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit, theksohet se Divizioni i Ankesave të Shfrytëzuesve të Shërbimeve Financiare në BQK trajton shumicën e ankesave në lidhje me shërbimet financiare.

Gjithashtu, theksohet se është bërë përparim në mbledhjen dhe raportimin e disa të dhënave në Eurostat, megjithatë nevojiten përpjekje të mëtejshme për t'i adresuar mospërpjethjet metodologjike në llogaritë kombëtare.

Statistikat mujore për tregtinë ndërkombëtare të mallrave janë raportuar në Eurostat. Ndërkaq të dhënat e bilancit të pagesave janë përpiluar nga Banka Qendrore dhe janë përgjithësisht në pajtueshmëri me aktet (aquis) të BE-së.

BKS-ja kërkon nga avokatët që të bëjnë marrëveshje për mbyllje të lëndëve 2002-2020

PRISHTINË, 13 TETOR - Mbi 40 avokatë që përfaqësojnë lëndë të ndryshme që lidhen ne Byronë Kosovare të

Sigurimit (BKS) janë prituri të enjten në këtë institucion nga drejtori Sami Mazreku. Ky i fundit ka kërkuar nga avokatët të

bëjnë marrëveshje për mbyllje të lëndëve të vjetra 2002-2020. Drejtori Mazreku ka bërë me dije se janë 785 lëndë që iu

përkasin viteve nga përfundimi i luftës e deri në fund të vitit 2020, e ku vlera e tyre llogaritet të jetë rreth 11 milionë euro.



DEMANTIM SHKENCOR DHE REAL TË KEQINTERPRETIMEVE PAUSHALLE ME OSE PA DASHJE, LIDHUR ME SIMBOLIN E DIELLIT DHE SIMBOLIT TË LIBRIT MBI DIELL NË DYERT METALIKE TË SHKOLLËS SË MESME “JETA E RE” NË THERANDË

DYERT METALIKE TË SHKOLLËS SË MESME “JETA E RE” NË THERANDË, ME SIMBOLET E DIELLIT DHE LIBRIN MBI DIELL, PARAQESIN SIMBOLET E PASTRA SHQIPTARO – ILIRO – PELLAZGE



Prof. dr. Eqrem ZENELAJ

Me kërkesën e drejtorit të shkollës së mesme “Jeta e Re” të Therandës, z. Fadil Elshani, jap këtë sqarim (demant), lidhur me të vërtetën për idenë, përmbajtjen (domethënien) dhe punën e bërë nga ing. Hajdin Berisha (martir i kombit) të detyrëve të oborrit të shkollës dhe inaugurimin e derës hyrëse të shkollës së mesme “Jeta e Re” në Therandë, është si vijon:

Ishte viti 1987/88, atëherë kur ishte drejtor i shkollës së mesme, profesori i im i nderuar dhe pothuajse i shumicës së kolektivit (tani i ndjerë), prof. Ramadan Kryeziu, ndërsa unë isha zëvendës i tij.

Vendosëm ta rrethojmë një pjesë të hyrjes së oborrit të shkollës me tela, ngase në oborr vazhdimisht hynin bagëtitë, të cilat e shëmtonin oborrin dhe e pengonin procesin mësimor. Pas bisedës që bëmë, erdhi deri te ndërtimi i derës kryesore të hyrjes në oborrin e shkollës.

U tubuam ne të tre: Unë, drejtori Ramadan Kryeziu, si dhe profesori i nderuar e atdhetari ing. Hajdin (Mursel) Berisha, ku ishte i angazhuar si mësimdhënës në shkollë dhe punëtor inxhinier në sipërmarrjen “19 Nëntori” (Komunalen) të Therandës...

E biseduam me drejtorin e shkollës, prof. Kryeziun dhe me prof. dr. Hajdin (Mursel) Berisha (tani i ndjerë dhe martir i kombit) se çfarë simboli t'i bëjmë këtij tempulli shkollor, që bënë dritë në arsimin tonë shqip të Therandës dhe në përgjithësi se cila ide do të lidhet me ndonjë thënie të Rilindjes Kombëtare. Unë, meqë isha i dhënë, që nga studimet në fakultet, lidhur me lashtësinë e historisë sonë shqiptare – iliro - pellazge, si dhe për simbolet pellazge, por edhe me filozofinë antike të Rilindjes Kombëtare - i pari i propozova drejtorit, Ramadan Kryeziu dhe ing. Hajdin Berishës (stërnip imi), që t'i vëmë aty në derën metalike dy simbole domethënëse kombëtare, duke cituar një thënie të Naim Frashërit - rilindësit tonë të madh se: **“Vetëm dritë e diturisë do të na shpjerë përpara”.**

Ata ma aprovuan këtë ide, por nga frika se mos po zbulohet kjo domethënie e këtyre dy simboleve,

biseduam që ta mbajmë në fshehtësi domethënien e tyre.

Sikurse drita që buron nga dielli, ashtu edhe dituria buron nga libri, nga leximi, nga arsimimi i popullit. Pra, Dielli dhe Libri janë të ndërlidhura në kuptimin shpirtëror e iluminist, kështu e mendonin edhe utopistët, Iluministët e po ashtu edhe rilindësit tanë.

Ndër utopistët ka qenë, Tommaso Campanella (1568-1639), teologu dhe mendimtari i Rilindjes Italiane, poet dhe astrolog, me librin e tij të shkruar në vitin 1602, me titull: “Qyteti i Diellit” (La città del Sole) dhe në latinisht: “Civita Solis”. Iluminizmi ishte një lëvizje kulturore në Europë, që filloi nga fillimi i shek XVIII e gjër te revolucionin francez, ku ky shekull u quajt shekulli artë. Fjala iluminizëm do të thotë ndriçim, pra ndriçim i dijes e kulturës dhe ndriçim e emancipim i njerëzimit.

Rilindja kombëtare shqiptare është periudha e veprimtarisë patriotike kombëtare, që synoi ngritjen e vetëdijes kombëtare shqiptare (fillon nga mesi i shek XIX dhe deri më 1912, që kishte thelbin formimin e shtetit kombëtar e njeri ndër ta ishte - Naim bej Frashëri...

Naimi Frashëri (rilindësi ynë i madh) e mendonte arsimimin e kombit me dritën e diturisë, e dritë e diturisë ishte libri, pra drita (dielli) apo rrezatimi i librit në emancipimin kombëtar shqiptar, bazuar në simbolin pellazg (diellin). Pra, libri dhe arsimit për shqiptarët është një dritë e diturisë kombëtare, dritë e emancipimit, ashtu sikurse dielli pellazg, ku pellazgët e mendonin dhe e besonin se Zoti i diellit është Apoloni (i biri i Zeusit pellazg). Apoloni e kishte simbolin e Zotit të Diellit, ku në gjuhën pellazge ai quhej në origjinal: “DIL” dhe “DEL” (por më vonë, Herodoti nga Halikarnasi ua shtoi mbaresat fjalëve: “Us”, “Os” dhe “Is”, e që pastaj nga helenët e rinj apo grekët e sotëm, mbaresat e fjalëve nga Herodoti, si Dielli u quajt: “Del - Os”.



Dyert e hyrjes së oborrit të shkollës tani pa libër mbi diell.



Dyert e hyrjes së oborrit të shkollës kështu ishin deri vonë.

Pra, këto ishin frymëzimet filozofike historike dhe kombëtare, që më lindi si ide për dizajnimin e derës së hyrjes në oborrin e shkollës së mesme “Jeta e Re” të Therandës, e që kjo shkollë kishte dhe ka privilegje ta ketë, si e vetmja në Kosovë, këto dy simbole, në dyert e hyrjes: Diellin dhe Librin!

Pra, unë e dhashë idenë e simbolit pellazg të Diellit, pastaj idenë filozofike të Tommaso Campanelles në veprën e tij: “Qyteti i Diellit”. Pra, në mënyrë që dielli aty paraqet rrezatimin apo dritën e arsimit e të diturisë shqiptare, ashtu sipas thënies së Naim Frashërit dhe rilindësit iluminist: **“Vetëm dritë e diturisë (arsimit) do na shpjerë përpara”.**

Prandaj, për ta bërë këtë projekt realitet dhe me karakter iluminist e kombëtar e ideuam, e dizajnuam dhe e ndërtuam derën e hyrjes kryesore për në oborrin e shkollës me diellin dhe mbi të librin e hapur me nga tri fletë metalike të salduar mbi diell. Kjo, pra, për ta paraqitur këtë shkollë si vatër e arsimit dhe e dijes, që lëshon rreze dielli dhe shndritja me arsimin shqip të penguar nga pushtuesit otomano - sllav me shekuj. Unë së bashku me drejtorin, prof. Ramadan Kryeziun e angazhuam ing. Hajdin Berishën (pagesa përafërsisht diku rreth 300 DM), që ta dizajnojë

profesionalisht dhe ta realizojë këtë ide iluministe kombëtare të Naim Frashërit. Ing. Hajdin Berisha, atëherë ishte me punë edhe në organizatën punuese komunale: “19 Nëntori” në Therandë. Ishte atdhetar, por edhe asistent në Universitetin e Prishtinës - në Fakultetin Teknik. Ne të tre biseduam mes vete, që askujt nga kolektivi të mos ia tregojmë idenë dhe domethënien e këtyre dy simboleve në dyert: Diellit dhe Librit, pasi ishim të rrezikuar dhe ashtu ngeli.

Kushdo që i interpreton tani ndryshe këto dy simbole në dyert të shkollës, ose është sharlatan ose i paditur!

Gjatë apo pas luftës, dikush e ka hequr Librin me tri fletë (të metalta) nga dera e hyrjes, që ka qenë i salduar mbi Diellin, pra kush dhe pse e hoqën Librin nga Dielli në derë?

Kujt i pengoi domethënia e këtyre dy simboleve në derë?

Kush e hoqi Librin nga Dielli dhe pse? E hoqën me vetëdije apo pavetëdije, duke e ditur apo pa e ditur përmbajtjen dhe domethënien e këtyre dy simboleve!

Pra, kjo është tërë e vërteta e idesë dhe domethënia e simbolit të Diellit dhe të Librit mbi Diell, si dhe ndërtuesit i detyrë të oborrit, sipas këtyre ideve të Naim Frashërit, iluministit dhe rilindësit tonë të madh!

Ne nuk guxojmë, që me simbolet tona kombëtare ilire e pellazge, të themi se janë simbole të huaja apo sllave. E dimë që Turqia i ka simbolet e Dardanisë (Yllin dhe Hënën). Sllavo Maqedonia - simbolin e Diellit (por, janë kombe artificiale dhe pa identitet). Lahuta është shqiptare dhe daton që nga shek XII para erës sonë, ku në burime e shkrime të vjetra edhe te Homeri, edhe te Dari i dardanëve e Dikti i Kretës thuhet se Parisi, djali i

Priamit (mbretit të fundit të Trojës) ai ruante delet në Malin Ida në Dardani dhe i binte - ekzekutonte në lahutë. Kurse sot serbët e kanë përvetësuar dhe e kanë futur Lahutën Dardane shqiptare në UNESCO, si të tyre! O tempora o mores!

Domethënia e diellit - simbol pellazg e pellazgët ishin baballarë të lireve, kurse ilirët ishin paraardhësit e shqiptarëve

Dielli, hëna, yjet, ishin simbole pellazge, ndërsa ata paraqesin zotat pellazgë.

Zoti i Diellit (Dil-it apo Del-it), ishte Apoloni, ndërsa Zoti i Hënës konsiderohej Diana, e motra e Diellit (Zotit Apolon), të cilët konsideroheshin fëmijët e Latones dhe të Zeusit.

Edhe sot shqiptarët betohen në diell, në qiell, në gur, në tokë, etj., si p.sh.:

Pasha diell, pasha tokë e qiell, pasha këtë gur i randë kjoftë mbi mue nëse nuk e thamë të vërtetën...

Simbolet pellazge i vodhën edhe popujt e tjerë, si: Turqia simbolet e Dardanisë (Yll e Hënë), sllavët (Maqedonia e sotme artificiale ka flamurin me shenjë pellazge - Diellin, por dihet se edhe vetë e pranojnë se shqiptarët janë ilirë dhe ilirët pellazgë, prandaj sllavët ardhacakë nga shek IV-VII në tokat e ilirëve nuk kanë as identitet kombëtar, as historik, të cilin edhe vetë autorët serbë e pranojnë si: Radeta Mihajliç, etj...

Prandaj, çdo interpretim tjetër i këtyre dy simboleve është ose miopi, sharlatanizëm, ose interpretim qellimkeq, pasi simbolet pellazge janë simbole shqiptaro - iliro - pellazge.

Me konsideratë dhe me krenari për këtë vepër të thjeshtë, por me përmbajtje e domethënie historike e kombëtare, ku aty Dielli e Libri mbi të simbolizon arsimin shqip të ndaluar e të penguar nga pushtuesit e trojeve shqiptare, siç ishin hordhitë osmane e serbosllave me shekuj deri me sot...

Ndërtuesit të derës së hyrjes në oborrin e shkollës së mesme “Jeta e Re”, ing. prof. Hajdin (Mursel) Berishës (i masakruar me tërë familjen nga forcat paramilitare e militare serbe, si dhe ish-drejtorit (të ndjerë), prof. Ramadan Kryeziu, shpirti u pastë dritë!

Prof. dr. Eqrem Zenelaj – “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut” – Hulumtues i 20 arkivave botërore

Vjenë - Prishtinë, më 10.10.2022

Historia e gjatë e ndikimit të Vladimir Putinit për ta destabilizuar Perëndimin



Rusia e Putinit përdor fondet. Por instrumentet e saj të ndikimit janë mbi të gjitha të tjerat.

I njëjti zyrtar i lartë i administratës së Xho Bajden, që në një video-konferencë raportoi se intelijenca amerikane ka zbuluar të paktën 300 milionë dollarë transferta sekrete për partitë politike, drejtuesit dhe politikanët e huaj në 24 vende që nga viti 2014, shtoi se Shtetet e Bashkuara, presin një përdorim në rritje të mjeteve të ndikimit të fshehtë nga rusët gjatë muajve të ardhshëm.

Kjo fushatë synon të sabotojë sanksionet ndërkombëtare për shkak të luftës në Ukrainë, si dhe për të ruajtur ndikimin e Rusisë në botë. Kur flitet mbi operacionet, për të cilat Kremlinisht akuzuar në të kaluarën për ndikim në politikën e jashtme, si për shembull me Brexit, zgjedhjen e Donald Trump president, protestat e separatistëve në rajonin e Katalonjës në Spanjë, humbjen e referendimit të Mateo Rencit në Itali, propagandës kundër vaksinave apo presion ndaj presidentit italian Serxho Matarrela për të inkurajuar formimin e një qeverie më pro-ruse, referenca është në thelb për një punë të kryer në platformat e rrjeteve sociale.

Sidomos përmes një Agjencie të Kërkimeve në Internet me seli në Shën Petersburg, e cila ka fituar pseudonimin “fabrika e trolleve”, dhe financuesi i së cilës është Jevgeni Prigozhin.

I ashtuquajtur “Kuzhinieri i Putinit” ka krijuar edhe kompaninë private të mercenarëve “Vagner” që synon

të përforcojë ndikimin e Rusisë në vende të ndryshme të botës.

Departamenti i Shtetit, ka deklaruar se ka dërguar dokumentacionin përkatës në ambasadat dhe konsullatat në vendet në fjalë. Por sipas shërbimeve amerikane, kjo shumë do të ishte vetëm maja e ajsbergut. Pra 300 milionë dollarët, janë vetëm një shumë minimale, dhe Moskë ndoshta ka preferuar të transferojë fonde të tjera më në fshehtësi.

Në të nuk përmenden emra apo vende, por Departamenti i Shtetit thotë se mund t’i bëjë publike së shpejti. Është e paqartë nëse ka ndonjë problem me hetimin apo deshifrimin, apo nëse emrat lihen qëllimisht pezull për të mbajtur dikë nën presion. Por fakti që financimi nuk është mjeti kryesor i ndikimit të Putinit, u përmend që në vitin 2017 gjatë një aktiviteti në Romë nga politologu ukrainas Anton Shekovcov.

Një nga ekspertët kryesorë në marrëdhëniet midis Putinit dhe lëvizjeve populiste të së djathtës dhe të majtës, dhe autor i një libri mbi historinë e tërheqjes reciproke midis Rusisë sovjetike dhe post-sovjetike dhe fashizmit dhe radikalizmit krahu i djathtë, Shekovcovdeklaroi në atë kohë se “provat më të forta për financimin real nga Rusia kanë të bëjnë vetëm me një grupim të vogël të ekstremist të djathtë në Poloni, që nuk ka shumë ndikim”.

Në fakt, ishin edhe 9 milionë eurot që mori hua në vitin 2017 partia e Marin Lë Pen nga “First Czech Russian Bank”. E themeluar në vitin 1996, me kapital në Pragë

dhe Moskë, e blerë në vitin 2002 nga “StroyTransGaz”, kompania ruse që ndërton gazsjellësit për “Gazprom”.

Më 20 prill, presidenti francez Emanuel Makron e sulmoi Lë Pen gjatë një debati elektoral dhe ajo u përgjigj: “Nëse u detyrova të shkoja jashtë vendit për një kredi, kjo ka ndodhur sepse asnjë bankë franceze nuk ka pranuar të ma japë atë. Unë jam një grua absolutisht e lirë”.

Por sipas hetimeve të mëvonshme nga “Le Monde” dhe “Mediapart”, Lë Pen u kishte kërkuar bankave ruse 40 milionë euro kredi. Më pas, në shkurt 2019, u zbulua historia e takimit të zhvilluar më 18 tetor 2018 në hotelin Metropol në Moskë, midis 3 italianëve dhe disa rusëve të paidentifikuar.

Ndër italianët ishte Khanluka Savoini, një drejtues i LEGA, partia e së djathtës ekstreme, president i shoqatës Rusi-Lombardi, ish-zëdhënës i Mateo Salvinit, dhe një lobist i fortë i marrëdhënieve midis Rusisë dhe kësaj partie. Flitet se në atë takim pati negociata për shitjen e naftës.

Marrëveshja parashikonte një financim të fshehtë të fushatës elektorale të LEGA në kuadër të zgjedhjeve për në Parlamentin Evropian. Tre milionë tonë naftë do të bliheshin nga “ENI” për 1.5 miliardë dollarë, ndërsa 65 milionë dollarë nga kjo shumë do të kalonin në arkën e LEGA-s.

Një ditë më herët, më 17 tetor, po në Moskë, Ministri i Brendshëm i atëhershëm Mateo Salvini kishte marrë pjesë në një takim të organizuar nga Confindustria në hotelin “Lotte”, ku mori pjesë edhe

Savoini. Në fakt, shumë analistë thanë menjëherë se ishin të sigurt se takimi ishte mbikëqyrur nga shërbimet ruse, pasi hoteli Metropol është dukshëm nën kontrollin e rreptë të FSB-së.

Në realitet, një marrëdhënie organike midis LEGA-s dhe regjimit të Putinit, ekziston në formën e një pakti bashkëpunimi me partinë Putiniane Rusia e Bashkuar. I nënshkruar në Moskë më 6 mars 2017, ai skadoi më 6 mars të këtij viti, por në mungesë të komunikimit u rinovua automatikisht deri më 6 mars 2027.

Siç kujtonte gjithmonë Shevkocov, në atë kohë LEGA votoi sistematikisht pozicionet pro Putinit në Evropë. Në Parlamentin Evropian kjo parti u inkuadrua brenda një grupi në të cilin ai është pjesë e një bërthame të fortë pro-Kremlinit, së bashku me partinë e Marin Le Pen dhe Partinë e Lirisë (FPÖ) nga Austria.

Nga kjo e fundit mund të kujtojmë sesi më 18 maj 2019 Hajnc –Kristian Strahe dha dorëheqjen si kreu i partisë, si zëvendëskancelar dhe Ministër i Shërbimit Civil dhe Sportit, pas publikimit nga gazetata “Suddeutsche Zeitung” dhe “Der Spiegel”, të një videoje të xhiruar në vitin 2017 në Ibiza, ku ai pranonte oferta rryshfeti nga e vetëquajtura mbesa e një oligarku rus, që ishte në fakt një gazetare investigative.

Tek kjo aleancë përfshihet “Alternativën für Deutschland” (Afd). Një investigim i përbashkët i vitit 2019 nga “Spiegel”, “ZDF” dhe “BBC” mbi përpjekjet e Kremlinit për të ndikuar tek parlamentet e

vendeve të BE-së në vitin 2017, u publikua një dokument mbi deputetin e Afd Markus Fronmaher. Sipas një raporti të inteligjencës së BE-së, ai u kishte kërkuar rusëve ndihmë për zgjedhjetparlamentare në Gjermani në vitin 2017, në këmbim të besnikërisë në politikën e jashtme. Po ashtu gjatë asaj fushate, 3 anëtarë të Afd shkuan në Moskë me bileta të paguara nga rusët.

Në fakt, muajt e fundit Afd-ja ka bërë një fushatë shumë të ashpër kundër sanksioneve, madje deri në atë pikë sa që kancelari Sholc e ka etiketuar atë si një “parti të Rusisë”. Pra ka dyshime për financime si dhe dëshmi për mbështetje. Në Itali, kjo ka të bëjë jo vetëm me LEGA-n, por edhe me partinë Pesë Yjet dhe Forza Italia.

Në të kaluarën në listë ishin edhe Fratelli D’Italia të Xhorxhia Melonit, por tani duket se kjo parti e ka ndryshuar radikalisht linjën e saj. Gjithsesi të tria partitë e qendrës së djathtë u akuzuan gjatë një interviste nga ish-ambasadorin amerikan në NATO, Kurt Volker. “Simpatitë e LEGA-s dhe Berluskonit për Rusinë ishin të njohura. Por tani mendohet se edhe Vëllezërit Italianë mund të kenë marrë para nga rusët. “Ne e dimë prej vitesh që rusët shpenzojnë për të ndikuar në zgjedhjet në të gjithë Perëndimin. Ata kërkojnë të nxisin ndarjen në shoqëritë tona dhe midis vendeve tona. 300 milionë nuk është ndonjë shumë e madhe. Por ajo ka përmirësuar perspektivat e disa partive, si ajo e Lë Pen në Francë dhe Fratelli D’Italia” - tha ai. / “Linkiesta” – Bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sanchez Martinez, gjyqtar i "El Clasico"-s

MADRID, 13 TETOR - Ndeshja Real Madrid - Barcelona po afron. Derbi më i madh në botën e futbollit, Barcelona - Real Madrid, do të zhvillohet në të dielën. Ndeshja pritet të jetë jashtëzakonisht interesante,

me dy skuadrat që mbajnë pozitat 1 dh 2 në ligë, me pikë të barabarta. Një detyrë e vështirë i është caktuar gjyqtarit Sanchez Martinez, i cili do ta ndajë drejtësinë në këtë takim. Sanchez do të jetë i

ndihmuar edhe nga teknologjia "VAR". Në dhomën e VAR-it drejtues do të jetë Hernandez Hernandez. Ndeshja në mes të Realit dhe Barcelonës do të luhet të dielën, me fillim nga ora 16:15.



Legjenda e futbollit rumun e vlerëson lart Kosovën

BUKURESHI, 13 TETOR - Adrian Mutu e ka paralajmëruar kombëtaren e Rumanisë se përballjet me kombëtaren e Kosovës nuk do të jenë aspak të lehta.

Legjenda rumune ia ka bërë një analizë Grupit I të kualifikimeve për Euro 2024 ku, krahas Rumanisë dhe Kosovës, bëjnë pjesë edhe Zvicra, Izraeli, Bjellorusia dhe Andorra.

Ish-futbollisti i Interit, Juventusit dhe Chelseat, e ka vlerësuar lart ekipin "Dardan", për të cilin thotë se rumunët duhet të jenë mjaft të kujdesshëm dhe të mos e shohin si punë të kryer fitoren para lojës. "Nuk e shoh si grup i lehtë. Shumë njerëz po thonë se nuk mund të ishte më mirë se kaq. Nëse i shikoni ndeshjet tona të fundit me Izraelin dhe me Zvicrën, nuk e di kur kemi fituar për herë të fundit. Pastaj nuk e kemi takuar

ndonjëherë Kosovën. Në nivelin ndërkombëtar, Kosova ka lojtarë që performojnë në kampionate shumë të forta. Kushdo që thotë se është një grup i lehtë, mund të dëshirojë t'i bëjë më shumë presion përzgjedhësit", ka thënë për "sport.ro" Mutu, i cili aktualisht është trajner i ekipit rumun Rapid București.

Ditë më parë Federata Rumune e Futbollit nuk siguroi se kombëtarja e këtij shteti do t'i zhvillojë ndeshjet me Kosovën, për të cilat tha se duhet të konsultohet me Qeverinë e Rumanisë.

Madje një ish-ministër i jashtëm rumun ka shkruar edhe më larg, duke thënë se Rumania nuk duhet të luajë me një shtet që s'e njeh, edhe nëse i humb të dyja ndeshjet, 0:3. Ndeshjet kualifikuese të Evropianit do të luhen në mes të marsit dhe nëntorit 2023.



Ten Hag për 700 golat e Ronaldos: Shumica e lojtarëve s'i arrijnë 700 ndeshje

MANCHESTER, 13 TETOR - Erik ten Hag është i mrekulluar nga rekordi i yllit portugez Cristiano Ronaldo. Pesë herë fituesi i Topit të Artë, Cristiano Ronaldo, ka arritur tashmë në kuotën e 700 golave (vetëm paraqitje me klube).

I pyetur për rekordin e lojtarit portugez, trajneri i Man Unitedit është shprehur i mrekulluar. Për të është aq madhështore të shënosh 700 gola kur, sipas tij, disa lojtarë s'arrijnë as 700 paraqitje. "Është fenomenale. Mendoj se Cristiano e di se s'mund ta bëjmë këtë pa skuadrën, por duhet ta them se është paraqitje e madhe individuale. Nëse e arrini këtë, është e jashtëzakonshme - 700 gola për klub dhe



kur e mendoni jo aq lojtarë kanë arritur 700 ndeshje dhe ai shënoi 700 gola. Kështu që, jam i lumtur për të. Vërtet dua t'ju them që e uroj atë", ka thënë Ten Hag.

Kroosi paralajmëron pensionimin nga futbollit?

MADRID, 13 TETOR - Toni Kroos ka folur lidhur me planet për të ardhmen e tij. Mesfushori gjerman Toni Kroos është pyetur edhe një herë për planet e tij për të ardhmen dhe komentet s'linin asgjë të sigurt.

Lojtari i Real Madridit e ka bërë të qartë vetëm një gjë: ai dëshiron të pensionohet te Real Madridi. Por, kur? "Unë e kam bërë të qartë që është Real Madridi skuadra ku dua ta mbyll karrierën. Në çfarë date? S'mund ta them. Ndoshta në një vit apo dy, ose më vonë, s'e di", ka thënë Kroosi.

Kroosi ka qenë pjesë kyçe e Real Madridit. Ai me skuadrën spanjolle ka fituar katër Champions League, përfshirë tri radhazi më 2015/16, 2016/17 dhe 2017/18.



'Bild'-i: Chelsea është gati të paguajë më shumë se 100 milionë për Bellinghamin


LONDËR, 13 TETOR - Ylli i Borussia Dortmundit, Jude Bellingham, është një nga mesfushorët më të komentuar së fundmi. Lojtari do të jetë në qendër

të vëmendjes në merkaton e verës 2023, me Liverpoolin, Cityn, Real Madridin që janë në garë për të, së fundmi edhe Chelsea. Gazeta gjermane "Bild" ka


bërë me dije se Chelsea ka kontaktuar tani me Dortmundin. "Blutë" e kanë njoftuar skuadrën gjermane se janë gati të paguajnë më shumë se 100 milionë euro

për nënshkrimin e Jude Bellinghamit. Favoritë për nënshkrimin e lojtarit vazhdojnë të jenë Liverpooli dhe Real Madridi.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr.464/01-53706/2
Datë: 11.10.2022

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4, nenit 7 dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë:Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë:/Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.20/21 Qershor 2016 Prishtinë, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:


VENDIM

I.Me këtë Vendim, PLOTËSOHET, Vendimi 01Nr.464/01-53706 i datës 04.10.2022, në faqen nr.2 të Përshkrimit detaj të parcelave kadastrale-objekteve sipas Certifikatës – ashtu që shtohen edhe 3 (tri) objekte – njësi banesore të cilat renditen pas numrit rendor 9 me shënime dhe përmbajtje si vijon:


K.K. Lipjan Gjendja e vjetër					K.K. Lipjan Gjendja e re		
Nr.	Pronar	Parcela kadastrale-Objektet	Kultura-klasa	Sipërfaqe m ²	Pronar	Kultura-klasa	Sipërfaqe për shpronësim m ²
10.	Ramize Zejnullahu (Bashk. E Muratit)	O-71409044-01747-3-46-1-3-0 ZK Lipjan	Banesë	39 m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	39m2
11.	Ramize Zejnullahu (Bashk. E Muratit)	O-71409044-01747-3-46-1-4-0 ZK Lipjan	Banesë	52 m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	52m2
12.	Ramize Zejnullahu (Bashk. E Muratit)	O-71409044-01747-3-46-1-II-0 ZK Lipjan	Bodrum	14.92 m ²	Komuna Lipjan	Park-Parking nëntokësorë	14.92m2

II.Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërin nga gazetat me tirazh më të madh.


I'u dërgohet:
-të gjitha Drejtorive
-Arkivit të Komunës



Page 1 of 1



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

PREDSIEDNIK OPŠTINE

01Br.464/01-53706/2
Dt: 11.10.2022

Na osnovu članovi 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova Br.28 dt. 4 Juni 2008, člana 4, člana 7 i člana 8 Zakona Br.03/L-139 za eksproprijaciju Nepokretne Imovine, Službena Novina Republike Kosova/ Priština:Br.52/08 Maj 2009 sa promenu i dopunu u skladu sa Zakonom Br.03/L-205,Službena Novina Republike Kosova / Priština:/Br.91/10 Decembar 2010, odredbe člana 83 Zakona za Administrativnih Opšti Procedura Br.05/L-031Službena Novina Republike Kosova Br.20/21 Juni 2016 Priština, člana 40 i 41 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021,Predsednik Opštine Lipljan donosi:


ODLUKU

I.Sa ovom Odlukom,POPUNJAVA SE, Odluka 01Br.464/01-53706 dt. 04.10.2022, na strani br.2 u detaljnom opisu katastarskih parcela-objekti prema Certifikatu – dodaju i 3 (tri) objekta–stambene jedinice koje su navedene iza rednog broja 9 sa sledećim napomena i sadržanjem:


K.K. Lipjan Staro stanje					K.K. Lipjan Novo stanje		
Br.	Vlasnik	Katastarska Parcela -Objekt	Kultura-klasa	Površina m ²	Vlasnik	Kultura-klasa	Površina za eksproprijaciju m ²
10.	Ramize Zejnullahu (Bashk. E Muratit)	O-71409044-01747-3-46-1-3-0 ZK Lipjan	Stan	39 m ²	Opština Lipljan	Park-Parking podzemljji	39m2
11.	Ramize Zejnullahu (Bashk. E Muratit)	O-71409044-01747-3-46-1-4-0 ZK Lipjan	Stan	52 m ²	Opština Lipljan	Park-Parking podzemljji	52m2
12.	Ramize Zejnullahu (Bashk. E Muratit)	O-71409044-01747-3-46-1-II-0 ZK Lipjan	Stan	14.92 m ²	Opština Lipljan	Park-Parking podzemljji	14.92m2

II.Odluka stupa na snagu nakon objavljivanja na Službenom Novinu Republike Kosova i nakon objavljivanja u jednom od novina sa najvećim tiražom.

Dostavljen:
-svim Direkcijama
-Arhive Opštine



Page 1 of 1



Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.A-Mitrovicë

Bazuar në neni 21, neni 25 paragrafi 25.2 pika h, Ligji nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike respektivisht neni 13 Ligji nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Komisioni i Auditimit i KRM “Uniteti”, Sh.A – Mitrovicë, vendosi të shpallë:

KONKURS

Pozita: Zyrtar/e Kryesor/e i/e Auditimit të Brendshëm
Përgjigjet: Komisionit të Auditimit të KRM “Uniteti”, Sh.A – Mitrovicë,
Vendi: Mitrovicë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë universitare - Fakulteti Ekonomi, Juridik, Administratë Publike, Financa Publike, kontabilitet, fusha të tjera përkatëse të studimit (minimum 240 ETC).
- Certifikatat për Auditor të Brendshëm në Sektorin Publik, lëshuar nga institucionet e akredituara në Kosovë ose organizatat vendore dhe ndërkombëtare të Akredituara;
- Së paku tri (3) vite përvojë pune në auditim;
- Integritet të lartë moral dhe profesional;
- Njohuri të shkëlqyera të Financave Publike, aftësi të dëshmuara në proceset e auditimit;
- Aftësi për të interpretuar dhe zbatuar Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe legjisllacionin në fuqi që i përgjigjet veprimtarisë së ndërmarrjes.
- Njohuri të mira të punës me kompjuter (Microsoft, Word, Excel etj.)
- Të mos jet i dënuar ose nën hetime
- Shkathësi të larta organizative dhe aftësi për të punuar nën presion me kualitete të larta, si dhe të ketë shkathësi të prezantimit dhe raportimit.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesorë:

- Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komitetit për Auditim dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, Zyrtari për Auditim të Brendshëm do të jet përgjegjës që
- Të rrisë dhe mbroj vlerën e organizatës duke ofruar siguri dhënie përmes auditimit dhe këshillëdhënies
- të bazuar në rrezik dhe objektivë.
- Të menaxhoj dhe organizoj funksionin e Auditimit të Brendshëm të KRM “Uniteti”, Sh.A Sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (IIA).
- Të hartojë Politikën e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me Misionin e Auditimit të Brendshëm dhe elementet e detyrueshëm të Kuadrit të Praktikave Profesionale Ndërkombëtare (Parimet Thelbësore të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Kodit të Etikës, Standardeve dhe Përkufizimit të Auditimit të Brendshëm).
- Auditori i Brendshëm duhet të rishikojë periodikisht statutin e auditimit të brendshëm dhe ta paraqesë atë për miratim të menaxhimit i lartë dhe Komisioni i Auditimit.
- Të hartoj dhe propozoj planin vjetor për vitin vijues të Auditimit të Brendshëm të KRM “Uniteti”, Sh.A për shqyrtim dhe miratim nga Komisioni i Auditimit.
- Të raportoj Komisionit të Auditimit për procesin e auditimit për secilën Njësi të KRM “Uniteti”, Sh.A
- Planifikon proceset e auditimit përmes së cilave vlerësohen kontrollat e brendshme dhe performanca, në pajtueshmëri me standardet profesionale;
- Përgatit dhe ekzekuton programe auditimi për të kryer auditime sipas planit vjetor duke përcaktuar objektivat e auditimit, kriteret e auditimit dhe duke identifikuar rreziqet dhe kontrollat;
- Dizajnon procedura testimi me qëllim të vlerësimit të adekuatshmërisë së kontrolleve të brendshme për përbushje të objektivave të auditimit;
- Siguron, analizon dhe vlerëson të dhënat mbështetëse (evidencat) përmes veglave të ndryshme ndihmëse;
- Përgatit raportet e auditimit që pasqyrojnë qartë objektivat e auditimit, fushëveprimin, gjetjet, rekomandimet, konkluzione;
- Kryen përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të mëhershme ;
- Kryen Ad Hock auditime dhe detyra tjera me kërkesën e KE-së dhe Komisionit të Auditimit të KRM “Uniteti” Sh.A;
- Siguron dokumentimin e letrave të punës sipas metodologjisë së aprovuar;
- Të ndihmoj në ruajtjen e kontrolleve efektive përmes: (i) Vlerësimit të efektivitetit dhe efikasitetit të kontrolleve.(ii) Nxitjes së përmirësimit të vazhdueshëm të mjedisit të kontrollit dhe (iii) Identifikimit të mundësive për përmirësimin e aktivitetit të kontrollit.
- Ndihmon në vlerësimin dhe përmirësimin e qeverisjes përmes: (i) Nxitjes së etikës dhe vlerave të përshatshme. (ii) Ofritit të siguri dhënies së menaxhimit efikas të performancës dhe llogaridhënies. (iii) Komunikimit efektiv të informacionit të rrezikut dhe kontrollit. (iv) Koordinimi efektiv i aktiviteteve të siguri dhënies.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacionit duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:
- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim,
- Diplomën e fakultetit – kopje e noterizuar,
- Dëshmitë e përvojës paraprake të punës,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj.

Dorëzimi i kërkesës/Aplikacionit dhe dokumentacionit përkatës bëhet Arkivin e KRM “Uniteti” Sh.A në Mitrovicë, me zarf të mbyllur me shënim: “Për pozitën e Zyrtar/e Kryesor/e i/e Auditimit të Brendshëm”. Konkursi zgjatë 30 ditë, dorëzimi i dokumenteve fillon nga data 14.10.2022 dhe përfundon në ora 16.00 të datës 12.11.2022.

Dokumentacionet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacion përkatës, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit të Auditimit. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa KA mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se "Avellino Lounge" SH.P.K. me pronar Nazmi Ramadanaj dhe Mehdi Muliqi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811937707 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavajte se svi klienti da drustvo sa "Avellino Lounge" D.O.O. sa vllasnikum Nazmi Ramadanaj dhe Mehdi Muliqi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811937707 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Avellino Lounge" L.L.C. with owner Nazmi Ramadanaj dhe Mehdi Muliqi, has come to the decision to quit its business: 811937707 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fabiola Borovci shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme, dëftesat, diplomën si dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Jashar Gashi shpall të humbur diplomën e SH.M.E.J-H "Kadri Prishtina" Prishtinë.

- KSHH- Klubi i Shejtaris Hajvalia, Pr. Shpall të pavlefshme certifikatën e numrit fiskal me nr: 600388830.

- Galerina Shala Kaçiu, shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit të Kolegjit "Iliria".

- Muharrem A. Sylja B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810117996.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokal in më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/737-867.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

U bënë 14 vjet nga ndarja e më të dashurit tonë



Milaim H. Misini

(20.04.1938-13.10.2008)

Vdekja të ndau nga Jeta, por jo nga zemrat tona.

E përkujtojnë: Familja Misini nga Prishtina dhe Korretica e Ulët.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909